

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësi Ramë Hyseni, si kryetar i kolegjit, gjyqtarëve Gani Avdiu dhe Albert Zogaj, si anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit A.J. të cilin e përfaqëson babai R.J.-përfaqësues ligjor nga fshati ... Komuna e Ferizajt, e këtë e përfaqëson Z.G., avokat nga Ferizaj, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "D." me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës të paditurës , të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.432/2010 i datës 29.01.2013, në seancën jo publike të mbajtur më dt. 13.09.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si të pabazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "D." me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj, C.nr.432/2010 i datës 29.01.2013.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar në pikën I të dispozitivit pjesërisht është aprovuar kërkesëpadia e paditësit si e bazuar dhe është obliguar e paditura që paditësit në emër të shpërblimit të dëmit të pësuar ti paguaj dhe atë, në emër të dhimbjeve fizike shumë prej 1.000 €, për frikën e përjetuar shumë prej 1.200 €, në emër të ushqimit të përforcuar shumë prej 100 € dhe në emër të kujdesit të personit të tretë shumë prej 100 €. Në pikën II të dispozitivit është refuzuar kërkesëpadia e paditësit mbi lartësitë e shumave të aprovuara në pikën I të dispozitivit dhe atë për dhimbjet fizike shuma prej 1.000 € dhe për frikën e përjetuar shuma prej 800 €. Në pikën II të dispozitivit është detyruar e paditura që paditësit ti paguaj shumat e cekura si në pikën I të dispozitivit, në shumë të përgjithshme prej 2.400 €, me kamatë ligjore si për mjetet e afatizuara për një vit pa destinim të caktuar, nga data e kryerjes së ekspertizës mjekësore me datë 27.12.2012 e gjer në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 691,00 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh pas marrjes së formës së prerë të aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka ushtruar ankesë për shkak të zbatimit të drejtë të së drejtës materiale, me propozim që gjykata e

shkallës së dytë ta aprovoj aneksen si të bazuar, ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar, ashtu që pjesën e gjykuar ta zvogëloj ose të njëjtin ta prishë dhe lëndën t'ia kthej gjykatës së shkallë së parë në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paditësi i cili thekson se ankesa e të paditurës është e pabazuar dhe nuk ka kurrfarë mbështetje në fakte apo prova me të cilat do të vërtetohej ajo në çka ajo pretendon në ankesë, në të vërtetë aktgjykimi i atakuar është plotësisht i drejtë dhe i bazuar, i ka propozuar gjykatës së shkallës së dytë që ankesën ta refuzoj si të pabazuar dhe ta vërtetoj aktgjykimin e atakuar.

Pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar dhe shkresave të lëndës, në pajtim me nenin 194 të LPK Gjykata e Apelit e Kosovës, ka vërtetuar se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.J. përmes përfaqësuesit ligjor – e ky përmes të autorizuarit të tij ka ushtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "D." me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, me të dhëna si në petitumin e kërkesëpadisë së precizuar, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata për të vërtetuar gjendjen faktike në procedurën e provave ka bërë administrimin e provave me leximin e parashtrësës për precizimin e padisë, raportin e aksidentit të datës 06.08.2010, ekspertizat e mjekëve ekspert, dr. A.T. ortoped-traumatolog, dr. N.M. psikiatër, raportin e spitalit të Ferizajt, të Qendrës Emergjente për paditësin i datës 06.08.2010 dhe pas vlerësimit të këtyre provave në kuptim të nenit 8 të LPK-së, si dhe duke marrë parasysh faktin se i autorizuari i të paditurës gjatë seancës së shqyrtimit kryesor nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë, pasi që për të gjitha format e dëmit paditësit i ka ofruar shumën prej 700 €, ndërsa lartësinë e dëmit e ka kundërshtuar, e lidhur me këtë gjykata ka bërë nxjerrjen e provave përmes mjekëve ekspert të cekur më lartë, ku sipas mjekut ekspert-ortoped paditësi në ditën e aksidentit ka pësuar lëndime trupore si ndrydhje të regjionit të kokës, plagë shqyese prerëse të regjionit të bërrylit të majtë dhe të regjionit zverkor, e të cilat lëndime sipas mjekut ekspert karakterizohen si lëndim të lehta trupore, e që nga këto lëndime të njëjtit janë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit të rëndë në kohëzgjatje prej 24 orësh, të intensitetit të mesëm 10 ditë, të intensitetit të ulët 3 muaj, ka pas nevojë për ushqim të përforcuar 10 ditë dhe ndihmën e personit tjetër për 15 ditë, ndërsa sipas mjekut ekspert – psikiatër nga lëndimi paditësi ka pësuar frikë primare e cila ka zgjatë disa sekonda, frikë sekondare të intensitetit të lartë që kanë zgjatur dy ditë dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët që kanë zgjatur 3 muaj, e gjykata duke u bazuar në faktin se baza juridike nuk ishte kontestuese, në ekspertizat e ekspertëve të cekur më lartë,

dispozitave të nenit 323 të LPK-së, nenit 178 par.1, 189 par.2, 190 dhe 200 të LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke konsideruar se lartësitë e aprovuara të dëmit janë shpërblim i drejtë, e të cilat paraqesin një formë të satisfaksionit që paditësi me këto mjete të plotësoj nevojat dhe të mirat materiale të dëmtuara që përndryshe nuk paraqesin si shpërblim absolut të dëmit.

Kjo gjykatë, duke e vlerësuar përfundimin dhe vendimin e gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se i njëjti është i drejtë, i bazuar, se ka mbështetje në dispozita ligjore si dhe në shkresat e lëndës, ndërkohë që janë dhënë edhe arsyet e justifikueshme të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurës kjo gjykatë i vlerëson si të pabazuara, pasi që gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë zbatim të drejtë të së drejtës materiale, për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, pasi që gjykata e shkallës së parë vendimin e saj e ka mbështet në provat relevante të cilat gjenden në shkresat e lëndës, si dhe dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë materien që ka të bëjë me këtë lloj të kompensimit të dëmit.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 195 par.1 pika d) lidhur me nenin 200 të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Ac.nr.696/2013 më dt. 13.09.2016

Kryetari i kolegjit,
Ramë Hyseni,

SHËNIM MBI VOTIM DHE VENDOSJE

Një zërit u vendos, në seancën jo publike të kolegjit të mbajtur më dt. 13.09.2016, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Referues ka qenë gjyqtari Ramë Hyseni.

V ë r t e t o j n ë:

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

1. _____

2. _____